

## PROGRAMI 300 QENDRAVE SHËNDETËSORE

## ZGJEROHET HARTA E SHËRBIMIT TË HEMODINAMIKËS

## INVESTIMET NË SPITALET RAJONALE

## PUNËSIMI I MJEKËVE TË RINJ

## SHËRBIMI I URGJENCËS NË TERRITOR

## PROCEDURA TË REJA PËR RIATDHESIMIN E FËMIJËVE

## MBROJTJE E MENJËHERSHME PËR GRATË E DHUNUARA

Rehabilitohet qendra shëndetësore 24 orëshe e Patosit, duke siguruar kushte dhe standarde bashkëkohore për 45 mijë banorë. Kjo qendër është një ndër 11 qendrat shëndetësore të rikonstruara në qarkun e Fierit.

Ka përfunduar rehabilitimi edhe i dy qendrave të tjera në Tiranë. Qendra shëndetësore e Pezës dhe "Qyteti i Nxënësve" në Kombin, ofrojnë sot një standard të ri shërbimi për rreth 15 mijë banorë.

Për herë të parë në Spitalin Rajonal të Fierit është hapur Njësia e Hemodinamikës, që i shërben pacientëve me probleme kardiake për rajonin e Jugut.

Investimi me vlerë 373 mijë euro, mundëson kryerjen e koronarografive për banorët e qarqeve Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Berat, të cilët nuk do të kenë më nevojë të udhëtojnë drejt Tiranës për këtë shërbim. Në këtë spital, pritet të kryhen rreth 1 mijë koronarografi në vit.

Në spitalin rajonal të Durrësit kanë filluar punimet për rindërtimin e Pediatriisë moderne. Investimi i qeverisë shqiptare me vlerë 2 milion euro, do të transformojë këtë spital në infrastrukturë dhe pajisje mjekësore të teknologjisë së lartë, me një kapacitet prej 70 shtretër. Rehabilitimi i Pediatriisë së Durrësit, i shërben jo vetëm këtij qyteti por edhe turistëve të shumtë që frekuentojnë plazhin gjatë sezonit veror.

Shtatë mjekë të rinj i shtohen ekipit të spitalit rajonal Durrës, pas përfundimit të ciklit të specializimit 4-vjeçar. Investojmë jo vetëm në infrastrukturë, por edhe në burime njerëzore. 167 mjekë të rinj specialistë, të cilët kanë kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë, do t'i shtohen ekipeve shëndetësore të spitaleve rajonale dhe bashkiake në të gjithë vendin, brenda muajit Mars.

Gjashtë autoambulanca moderne i janë shtuar spitaleve të Bulqizës, Sarandës, Fierit, Elbasanit, Lezhës dhe Beratit. Me autoambulanca të reja dhe koordinim nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, sigurojmë përgjigje më të mirë të urgjencës në territor dhe shërbim më cilësor për qytetarët.

Miratoen procedurat e reja për riatdhësimin e fëmijëve të pashoqëruar. Vendimi i fundit i Këshillit të Ministrave synon të garantojë të drejtat e fëmijëve të pashoqëruar dhe t'i ofrojë atyre mbrojtjen më të lartë të mundshme, nëpërmjet krijimit të një sistemi të integruar mbrojtjeje dhe koordinimit efikas të të gjitha institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse.

34 gra të dhunuara së bashku me 56 fëmijë, po trajtohen në Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje. Me ndryshimet në ligjin "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare", gratë, viktimat e dhunës, marrin urdhër paraprak të menjëherëshëm mbrojtjeje, deri në daljen e vendimit të gjykatës, për t'u strehuar menjëherë në qendrat e kujdesit social. Urdhër mbrojtjeje marrin edhe fëmijët, pavarësisht nëse ndaj tyre është ushtruar dhunë ose jo.